



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.2836/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Nora Billaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit S.D. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson RR.A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.R., për kompensim dëmi, vlera e kontestit 714.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.941/16 të dt.22.11.2019, në seancën e kolegjit e mbajtur me datë 27.07.2021 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.941/16 i dt.22.11.2019, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.D. nga fshati ..., Komuna Podujevë dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të dëmit material të shkaktuar në automjetin "WV Passat", me targa ..., në aksidentin e datës 25.01.2016, t'ia paguaj shumën prej 714.00 euro, me kamatë prej 8%, duke filluar nga data 22.11.2019, kur është marrë aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 648.40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore ato të përgjigjes në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK, gjeti se:

**Ankesa e të paditurës, është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se: i autorizuari i paditësit në padi dhe gjatë seancave të mbajtura gjyqësore ka theksuar se, aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me dt.25.01.2016, në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, në Veternik, në të cilin aksident automjeti i tipit “VW Passat”, me targa ....., pronë e paditësit, është goditur nga automjeti i tipit “Renault”, me targa ....., i cili në momentin e aksidentit ka qenë i siguruar tek e paditura dhe si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka pësuar dëm material. Ka shtuar se, oferta e të paditurës në shumën prej 600€ është e pa pranueshme për paditësin, për shkak se me ekspertizën e makinerisë, është përcaktuar vlera e saktë e dëmit dhe se e paditura ka mundësi që ta kundërshtoj ekspertizën. Po ashtu në fjalën përfundimtare ka theksuar se, e paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadiës, por vetëm lartësinë, ku për të vlerësuar dëmin e shkaktuar është nxjerrë ekspertiza e makinerisë, me të cilën është konstatuar dëmi në vlerë prej 714.00€. Ka propozuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit në tërësi si e bazuar. Shpenzimet i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar provat dhe vlerësuar ato dhe në fund ka marrë aktgjykimin me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadiinë e paditësit në tërësi si të bazuar, më decidivisht të përshkruar si në dispozitivin ne aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit, nga gjykata e shkallës së parë theksohet se, nga provat e administruara po ashtu edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, gjykata vërtetohet se është e pa kontestueshme se automjeti “VW Passat”, me targa ....., si pasojë e aksidentit të dt.25.01.2016, ka pësuar dëm material. Po ashtu mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues se, paditësi është pronar i automjetit në fjalë. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë vërtetohet se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues baza juridike, por vetëm lartësia e dëmit të shkaktuar në aksidentin e dt.25.01.2016. Se paditësi ka pësuar dëmtime në disa pjesë të automjetit, vërtetohet nga akt-ekspertim dëmi (procesverbali i dt.25.01.2016), i realizuar nga e paditura. Gjykata po ashtu vlerësoj edhe faturat e paraqitura nga paditësi, për përlllogaritjen e dëmit dhe konsideroj se duhet të vlerësohet edhe nga eksperti i makinerisë. Kështu që, nga ekspertiza e ekspertit të makinerisë S.B. të dt.08.11.2019, të përpiluar me shkrim, dëmi i shkaktuar në automjet, nga ana e ekspertit është llogaritur në bazë të riparimit të tij, duke u bazuar në tarifrat dhe çmimoret e serviseve të autorizuar që operojnë në Kosovë. Sipas ekspertit, dëmi i shkaktuar përfshinë çmimin prej 714,00€, me detaje të përshkruara si në ekspertizë, të cilës gjykata e shkallës së parë ia fali besimin e plotë, pasi që e njëjta është profesionale dhe ligjore. Ndërsa sa i përket vërejtjeve të paraqitura në ekspertizë nga e paditura, gjykata i refuzoj si të pabazuara, sepse e njëjta nuk ka argumentuar se ku konsistojnë vërejtjet e saj, nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga eksperti dhe po ashtu nuk ka propozuar marrjen e ndonjë ekspertize të re.

Gjykata e shkallës së parë në gjithë shumatat e gjykuara ka caktuar edhe kumatën ligjore për dëmin material duke e bazuar këtë në dispozita përkatës e ligjore të LMD-së, dhe ka vendosur që të aprovoj kërkesëpadiinë e paditësit për dëmin e shkaktuar me aksidentin e komunikacionit të dt. 25.01.2016, e po ashtu bazuar edhe në mendimin dhe vlerësimin profesional të ekspertit të makinerisë. Krejt në fund ka vendosur edhe lidhur me shpenzimet e procedurës, duke dhënë sqarimet përkatëse, të cekura më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Këtë gjendje faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, nenit 136, 159 par.1, 173 par.1, 169, 173, 174, 245 dhe 382 të LMD-së, si dhe nenit 449 dhe 452 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar.

Sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës, që gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë është vërtetuar gjendja faktike në këtë çështje kontestimore të paditësit, ngase duke u bazuar në prova konkrete të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykimin e saj të ligjshëm dhe të drejtë, duke vendosur si në dispozitivin e tij. Aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë, e ka bazuar në dispozita konkrete ligjore që aplikohen në situata të tilla si kjo e paditësit, duke i caktuar paditësit kompensimin e dëmit material dhe këtë duke u bazuar në mendimin profesional të ekspertit të makinerisë, i cili në ekspertizën e tij të dt.08.11.2019, ka konstatuar se, duke e llogaritur në bazë të riparimit të tij, pra automjetit të paditësit, duke u bazuar në tarifat dhe çmimoret e serviseve të autorizuara që operojnë në Kosovë, sipas ekspertit, dëmi i shkaktuar përfshinë çmimin prej 714,00€, me detaje të përshkruara si në ekspertizë. Ndërsa e paditura, lidhur me këtë ekspertizë të ekspertit të makinerisë S.B., ka paraqitur vërejtje, mirëpo nuk ka kërkuar ndonjë sqarim shtesë të ekspertit, e po ashtu nuk ka propozuar nxjerrjen e ndonjë ekspertize të re për vlerësimin e dëmit material në automjetin e paditësit. Kështu që, pretendimi ankimor për gjykimin e shumës të lartë për dëmin material, për paditësin, është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm dhe si i tillë u refuzua nga kjo gjykatë.

Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës, që gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe që aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim, pasi që një vendim të tillë gjykata e shkallës së parë e mori bazuar në ekspertizën profesionale të ekspertit të makinerisë, ndërsa sa i përket pretendimit ankimor që gjykata nuk i mori parasysh faturat e paraqitura si në shkresat e lëndës, po ashtu nuk qëndron, ngase gjykata të njëjtat i vlerësoj mirëpo nuk i konsideroj si të bazuara, andaj edhe ka caktuar ekspertin gjyqësor, te lëmisë përkatëse, për vlerësimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar. Kësaj ekspertize, gjykata e shkallës së parë ia ka falë besimin e plotë, e të cilën si profesionale e pranon edhe kjo gjykatë.

Pra, Gjykata e Apelit vlerëson se, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, në harmoni të plotë me arsyetimin e dhënë dhe në të njëjtin janë dhënë arsye konkrete për faktet me rëndësi vendimtare për një vendosje të tillë, e atë bazuar në ekspertizën e ekspertit të makinerisë, i cili ka dhënë mendimin dhe vlerësimin e tij profesional dhe duke caktuar kështu vlerën e përgjithshme të lartësisë së dëmit në shumë prej 714.00€, të shkaktuar paditësit në automjetin e tij.

Andaj, i pa qëndrueshëm është pretendimi ankimor i të paditurës që gabimisht është zbatuar e drejta materiale dhe që shuma e gjykuar është e lartë, sepse gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar dhe arsyetuar lartësinë e dëmit material, e po ashtu në pajtueshmëri me dispozitat ligjore përkatëse.

Prandaj, në këtë aspekt nuk mund të konsiderohet se paditësit i është caktuar shuma e lartë për këtë kategori të dëmit material. Krejt këto janë caktuar nga gjykata e shkallës së parë bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe në pajtim me konstatimin dhe mendimin profesional të ekspertit të makinerisë.

Prandaj, edhe Gjykata e Apelit shumë e caktuar të dëmit material të cilin e ka pësuar paditësi në veturën e tij e vlerësoj reale, ndërsa aktgjykimi i atakuar është si rrjedhojë e zbatimit të dispozitës së nenit 136 të LMD-së në të cilën dispozitë në mënyrë decisive parashihet se *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Kështu ka vepruar edhe gjykata e shkallës së parë, në rastin konkret të paditësit, kur e ka detyruar të paditurën për kompensimin e dëmit material paditësit, në shumën e cekur si në ekspertizën e makinerisë, të punuar lidhur me rastin konkret.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës, por të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk patën ndonjë ndikim që gjykata të vendos sipas propozimit ankimor, përkatësisht ta prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën ta kthej në rigjykim, siç ka pretenduar e paditura.

Sipas Gjykatës së Apelit, të gjitha këto që u cekën në dispozitat e sipër cekura ligjore, gjykata e shkallës së parë i ka pasur parasysh me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar kur ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit vlerëson se, për dëmin material të shkaktuar paditësit, si pasojë e këtij aksidenti gjykata e shkallës së parë i ka caktuar edhe kamatën përkatëse ligjore, siç përcaktohet me dispozitën e nenit 382 të LMD-së. Krejt në fund gjykata e shkallës së parë, duke pasur parasysh suksesin e paditësit në procedurë me të drejtë ka vendosur që të aprovoj kërkesën për shpenzimet e procedurës kontestimore, të përshkruar në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar, e duke gjetur mbështetje në dispozitën e nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se, shumën e dëmit material e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë, është reale dhe konform mendimit profesional të ekspertit të makinerisë për rastin konkret, sepse gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e atakuar e ka marrë në përputhje të plotë me ekspertizën e makinerisë dhe gjendjen faktike të vërtetuar paraprakisht.

Prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje, e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës.

Meqenëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, dhe nuk ekzistojnë shkelje esenciale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, sipas nenit 194 të LPK-së, konform dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË  
Ac.nr.2836/2020 me dt.27.07.2021

Kryetari i kolegjit-gjykatësi  
Gëzim Llulluni